



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K2/M3-10 Prot.
Nr. Dok. 202502460/10

Tiranë 23/10/2025

Lënda: *Marrjen e masave për respektimin e afatit të arsyeshëm në kuadër të procedimit penal.*

PROKURORISË SË PËRGJITHSHME
Tiranë

KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË
Tiranë

KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Komisionit për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike
Tiranë

MINISTRISË SË DREJTËSISË
Tiranë

PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
Tiranë

Të nderuar,

Në institucionin e Avokatit të Popullit është regjistruar ankesa e shtetases M.S, lidhur me zvarritjen nga ana e organit të Prokurorisë Tiranë të kryerjes së ADN-së së zemrës së vëllait të saj S.S, i cili ka humbur jetën në shtetin spanjoll.

I. Konteksti i çështjes

I ndjeri S.S ka ndërruar jetë në datë 09.05.2020, në spitalin “Hospital Del Mar”, me adresë “Passeig Maritim de la Barceloneta” nr.25, 29 Kodi Postar 08003, Barcelonë.

Sipas deklaramit të saj, shtetasja M.S sqaron se fillimisht në datë 08.05.2020 e ka shoqëruar të vëllanë në spitalin Hospital Del Mar në Barcelonë, pasi nuk ndihej mirë, kishte temperaturë 37.5-38. Testi i Covid-19 i kryer në spital kishte dalë negativ. Ajo ka komunikuar disa herë me spitalin për gjendjen e tij, si dhe është paraqitur në recepsion, ku ka kërkuar edhe ta marrë në shtëpi, me qëllim që të kujdesej vetë.

Në datë 09.05.2020 ora 18.00 i ka telefonuar doktoresha nga spitali për t’i thënë të shkonte në spital. M.S ka shkuar në spital me mendimin që do marrë të vëllanë në shtëpi, por i kanë thënë që ai kishte ndërruar jetë, pasi i kishte pushuar zemra. (Duke shtuar se ndoshta mund të kenë bërë ndonjë gabim, por që do të çohet për autopsi në mjekësinë ligjore në Barcelonë).

Pas ngjarjes, M.S i ka kërkuar spitalit kopje të kartelës klinike të të ndjerit, e cila i është vënë në dispozicion pas kërkesës. Në kartelën klinike shkruhet *“i bëmë një ampul haloperidol i pushoi zemra në pak sekonda, nuk dimë arsyen.”*

Më datë 11 ose 12 maj 2020 në Mjekësinë Ligjore në Barcelonë, motra e të ndjerit, shtetasja M.S ka marrë kopje të autopsisë preliminare, ku nuk është përcaktuar përfundimisht shkaku i vdekjes, pasi pritej të kryhej një autopsi definitive dhe ishin marrë mostra të mushkërive, mëlçisë dhe zemrës.

Shtetasja M.S ka pretenduar se, shkaku i vdekjes së vëllait të saj ka qenë neglizhenca e kujdesit të stafit mjekësor në shtetin spanjoll, për këtë arsye familjarët kanë kërkuar kryerjen e një autopsie të dytë në Tiranë.

Në vijim, është marrë vendimi i datës 27.05.2020 për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor të kufomës, pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë, për të zbuluar shkaku të vdekjes së të ndjerit S.S.

Në funksion të hetimit nga organi i akuzës, është bërë këqyrja e kufomës, në ambientet e morgut të Institutit Mjekësor Ligjor Tiranë, ku nga këqyrja nuk janë konstatuar shenja dhune/dëmtime.

Në përfundim të autopsisë së dytë, ankuesja është vënë në dijeni nga organi i akuzës për konkluzionet e arritura në aktin e ekspertimit mjeko-ligjor nr.540 regj., datë 07.10.2020, **mungesa e zemrës së të ndjerit S.S.**

Referuar konkluzioneve të këtij ekspertimi mjeko-ligjor, ka rezultuar se: *“Në trupin e tij, në këqyrjen e jashtme përveç prerjeve autoptike dhe ndryshimeve pas vdekjes, **nuk** u vunë re dëmtime të shkaktuara nga dhuna. Në këqyrjen e brendshme të organeve dhe të dhënave*

*mikroskopike u konstatua – Bronkopneumoni sero-deskuamative. Aderenca pleurale në anën e djathtë të gjoksit. Hepatit kronik persistent. Autolizë e organeve. **Mungesë e zemrës.***

Në mungesë të ekzaminimit të zemrës, i cili është një organ jetik dhe i rëndësishëm nuk mund të përcaktohet shkaku i vdekjes së viktimës me saktësi shkencore.

*Në gjakun e viktimës **nuk** u zbuluan metabolite të medikamentit haloperidol.”*

Nga përshkrimi në kartelën mjekësore të spitalit spanjoll ku citohet se “*i bëmë një ampul haloperidol i pushoi zemra në pak sekonda, nuk dimë arsyen*” krahasuar me rezultatin e ekspertizës mjeko-ligjor nr.540 regj., datë 07.10.2020, konstatohet mospërputhje e fakteve.

M.S ka theksuar se nga ana e saj nuk është bërë në mënyrë kategorike dhurim “zemre” apo të jetë dhënë autorizim për marrjen e organeve të të ndjerit, vëllait të saj.

Në vijim të aktit të ekspertimit të kryer nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë **është regjistruar procedimi penal nr.6607, datë 09.10.2020** për veprën penale “*Shitblerja e paligjshme e organeve*”, parashikuar nga neni 89/a i Kodit Penal¹.

Gjatë hetimit penal, janë administruar deklaratimet, dokumentet spitalore me procesverbal këqyrjeje të datës 26.10.2020, dokumente të vëna në dispozicion nga motra e të ndjerit, fotokopje e autopsisë preliminare, jo definitive në gjuhën spanjolle, fotokopje e kartelës klinike të pacientit S.S, marrë pranë spitalit në shtetin spanjoll.

Avokati i Popullit vlerëson të drejtë vendimmarrjen e mësipërme për hetim të mëtejshëm, pasi në parim pas ekzaminimit organet kthehen në trupin e të ndjerit dhe i dorëzohen familjes për të vijuar me procedurat e varrosjes (referuar nenit 18 të dekretit mbretëror 32/2009²).

Ka raste kur një shtet mund të mbajë trupin ose organet e një personi të vdekur, por në kushte të caktuara p.sh kur është hapur një hetim penal, për të kryer autopsinë ligjore, për arsye shëndeti (të sëmundjeve ngjitëse), transplantimi etj. Megjithatë, edhe në këto raste familjarët kanë të drejtë të dinë arsyet dhe të kërkojnë dokumentacion zyrtar, si dhe kanë të drejtë të ndjekin rrugën ligjore nëse dyshojnë për abuzim.

¹ Neni 89/a: **Shitblerja e paligjshme e organeve**

Shitblerja e transplantëve, si dhe çdo veprimtari që lidhet me heqjen dhe implantimin e paligjshëm të organeve, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

Kjo veprë e kryer nga personi që shpërdoron pozitën e tij ndaj një fëmije ose një personi tjetër të pambrojtur, dënohet me burgim nga shtatë deri në dhjetë vjet.

Kjo veprë, kur kryhet më shumë se një herë ose në bashkëpunim, dënohet me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur nga vepra e mësipërme shkaktohet vdekja e viktimës ose kjo veprë kryhet nga grup i strukturuar kriminal ose organizatë kriminale dënohet nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet e pesë vjet burgim.

² <https://interjuez.es/2024/04/26/asistencia-a-familiares-y-obtencion-de-datos-ante-mortem-en-sucesos-con-victimas-multiples/>

Në zbatim të nenit 509/1, 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë dhe nenit 15 të Konventës Evropiane “*Për ndihmë të ndërsjellë juridike në fushën penale*”, në interes të procedimit penal nr.6607, datë 09.10.2020 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, bazuar në parimin e reciprocitetit dhe vullnetin e mirë të autoriteteve gjyqësore të Republikës së Spanjës, në datë 09.02.2021 u është kërkuar autoriteteve spanjolle vënia në dispozicion të prokurorisë e disa akteve në lidhje me këtë çështje. Nga Ministria e Drejtësisë rezulton se u është dhënë rrugë letërporosive për autoritetet spanjolle, por nuk ka pasur asnjë përgjigje.

Shtetasja M.S ka iniciuar një proces gjyqësor në Barcelonë Spanjë, në të cilin ka kërkuar rrethanat në të cilat është hequr zemra e të ndjerit S.S me datë 09.05.2020, si dhe njëkohësisht ka kërkuar kryerjen e ADN-së së zemrës së regjistruar me nr.B20-02222. Kjo kërkesë është rrëzuar nga Gjykata e Barcelonës, duke e pushuar çështjen penale, me argumentin se nuk kishte prova që ndalimi i zbatuar ndaj të riut shqiptar i shkaktoi atij vdekjen, si dhe refuzoi të bënte testin e ADN-së së zemrës së tij.

Si nga deklaratimet e ankueses, po ashtu edhe nga dokumentacioni i administruar nga ana jonë gjatë hetimit administrativ, rezulton se nuk janë kryer hetime në shtetin spanjoll dhe nuk ka procedim të hapur për këtë çështje.

Në vijim të veprimeve hetimore të kryera dhe dokumentacionit të dërguar nga prokuroria shqiptare, konstatohet se në bazë të procesverbalit “*Për dorëzimin dhe marrjen e organit zemër*” datë 12.07.2023 në laboratorin e Institutit Kombëtar të Toksikologjisë Barcelonë është bërë këqyrja dhe marrja e provës materiale “*Mostra e organit zemër e shtetasit të ndjerë S.S*”. Procedura është kryer nga oficerët e policisë gjyqësore: Gevi Gazheli dhe Erald Baca, në prezencë të Dr.Vjola Fera me detyrë mjeke eksperte në Institutin e Mjekësisë Ligjore (IML).

Menjëherë, nga ana e organit të akuzës në Shqipëri, më datë 19.07.2023 është marrë vendimi për kryerjen e ekspertimit biologjik pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore (IML-së).

Nga akti i ekspertimit biologjik ADN-je nr.9272, datë 04.10.2023 është arritur në konkluzionin se “mostrat e përgatitura nga ADN nga ind si ai i zemrës (provë materiale), objekt ekspertimi nuk u përfitua asnjë profil gjenetik.”

Duke qenë se në Shqipëri ka qenë i pamundur përcaktimi gjenetik i ADN-së, me qëllim zbardhjen e ngjarjes, është komunikuar për ndihmë juridike me Ministrinë Federale të Drejtësisë së Belgjikës (*shkresa e fundit është nr.2358/4 prot.D.S, e datë 08.11.2024, ndërkohë që prokuroria pretendon se është janar 2025*) dhe Ministrinë Federale të Drejtësisë të Austrisë për të marrë përsipër të realizojë ekspertizën e organit zemër, ku është kërkuar:

- Të përcaktohet profili gjenetik (ADN) të të ndjerit S.S, ku organi zemër së bashku me mostra të tij të ruhet në formalinë.
- Të përcaktohet shkaku i vdekjes së shtetasit S.S.

Ndërkohë, duhet theksuar se nga organet e shtetit spanjoll referohet se studimi histopatologjik i zemrës së të ndjerit S.S është bërë më datë **22.04.2020, kur ky shtetas ka ndërruar jetë në datë 09.05.2020** (përpara vdekjes).

Nga rrethanat dhe faktet e paraqitura nga shteti spanjoll, konstatohet mospërputhje, si dhe njëkohësisht nuk ka narrativë kronologjike të fakteve dhe veprimeve të kryera nga autoritetet spanjolle, **pasi** konfirmohet se studimi histopatologjik i zemrës së të ndjerit S.S është kryer më datë 22.04.2020, ndërkohë që ai ka ndërruar jetë në datë 09.05.2020. Pa përjashtuar mundësinë e ndonjë gabimi material në komunikime, në lidhje me këtë çështje del nevoja e një hetimi gjithpërfshirës.

Procedimi penal nr.6607, është regjistruar në datë 09.10.2020 për veprën penale “*Shitblerja e paligjshme e organeve*”, parashikuar nga neni 89/a i Kodit Penal dhe kanë kaluar **5 vjet nga fillimi i hetimeve** për këtë çështje dhe ende nuk ka përfunduar hetimi i saj, duke patur parasysh edhe specifikën e kësaj ngjarje. **Njëkohësisht, konstatojmë se kanë kaluar 2(dy) vjet nga marrja e zemrës si provë materiale dhe nuk është kryer ekzaminimi mjeko-ligjor i zemrës së regjistruar me nr.B20-02222, të marrë në datën 12 korrik 2023 nga shteti spanjoll dhe të sjellë në Shqipëri.**

Në kuadër të ndjekjes së këtij procedimi penal, që ka në qendër rrethanat e vdekjes së një shtetasi, është konstatuar se një nga provat kyçe për sqarimin e shkaqeve dhe përgjegjësiive të mundshme është ekspertimi i ADN-së së zemrës së viktimës.

Pavarësisht kalimit të një kohe të konsiderueshme që nga marrja e këtij organi biologjik si provë materiale, **deri më sot nuk është kryer analiza përkatëse e ADN-së, duke sjellë vonesa të pajustificuara në ecurinë e hetimeve dhe rrezik për cenimin e provave duke çuar në pamundësi për zbulimin e së vërtetës.**

II. Hetimi administrativ

Të ndodhur në këto kushte, familjarët (trashëgimtarët) e viktimës kanë shprehur shqetësimin e tyre dhe kanë parashtruar në institucionin e Avokatit të Popullit pretendimet për zvarritje të pajustificuar të hetimeve për çështjen nga organi i akuzës dhe institucionet e tjera shtetërore.

Nga institucioni i Avokatit të Popullit është nisur hetimi administrativ lidhur me rastin. Në bazë të nenit 63/4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë “*Organet dhe funksionarët publike janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij*” si dhe në bazë të nenit 19 gërma “b” të

ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kemi kërkuar informacion të detajuar për procedimin penal dhe ecurinë e tij, gjithashtu për ekzaminimet e kryera nga Instituti i Mjekësisë Ligjore dhe Instituti i Policisë Shkencore, si dhe korrespondencën e mbajtur me Ministrinë e Drejtësisë³.

Nga hetimi administrativ rezulton si më poshtë:

- Me shkresën **nr.3350 prot., datë 01.02.2025**, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë sqaron se, nga ana e organit procedues është marrë vendimi për kryerjen e aktit të ekspertimit biologjik krahasues ADN-së së zemrës së të ndjerit S.S dhe nënës së tij (për krahasim), por kjo e fundit nuk është paraqitur pranë IPSH-së, megjithëse ka marrë dijeni. Ndërsa ADN-ja e zemrës nuk mund të realizohet në kushtet e infrastrukturës së IPSH-së, kjo për faktin se, “**zemra është e ruajtur në formalinë**” dhe duhet bërë fillimisht denatyralizimi, gjë e cila nuk mund të realizohet nga IPSH-ja.
- Në këto kushte, kjo edhe sipas sugjerimit të përfaqësuesve ligjorë të familjarëve të të ndjerit, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka dërguar letërporosi pranë autoriteteve përkatëse austriake dhe belge për të kryer ADN-në e zemrës së të ndjerit.
- Nga ana e **autoriteteve austriake** është kthyer përgjigje, se **nuk** mund të realizohet kjo analizë shkencore, pasi vepra për të cilin është regjistruar procedimi penal nuk e bën të mundur këtë gjë, sipas legjislacionit austriak.
- Përsa i përket **autoriteteve belge**, nga ana e tyre **nuk** është kthyer ende asnjë përgjigje, megjithë shkresat zyrtare të prokurorisë dhe të Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë (gjithsej janë dërguar tre shkresa nr.2142/2BProt./D.S, datë 17.01.2024; nr.2358/1.prot./D.S, datë 03.07.2024; nr.2358/4 prot./D.S, datë 08.11.2024).
- Në një takim të zhvilluar në muajin nëntor midis Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë dhe përfaqësuesve të ardhur nga Prokuroria Belge, është diskutuar kjo problematikë, **por nuk ka ende asnjë përgjigje prej tyre.** Komunikimi i fundit ka qenë në muajin janar të vitit 2025.

³ Kërkesë nr.K2/M3-4 prot., datë 29.01.2025 drejtuar prokurorisë, kthim përgjigje nr.3359/1 prot., datë 11.02.2025

Kërkesë nr.K2/M3-5 prot., datë 29.01.2025 drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, kthim përgjigje e ministrisë nr.2358/9 prot., datë 04.02.2025

Kërkesë nr.K2/M-3 prot., datë 29.01.2025 drejtuar Institutit të Mjekësisë Ligjore, kthim përgjigje e Institutit nr.1178/1 prot., datë 10.02.2025.

Kërkesë nr.K2/M3-3 prot., datë 29.01.2025 drejtuar Institutit të Policisë Shkencore, kthim përgjigje nr.523/1 prot., datë 04.02.2025 e Institutit të Policisë Shkencore.

Kërkesë nr.K2/M3-9 prot., datë 29.03.2025 drejtuar Institutit të Policisë Shkencore, kthim përgjigje e IPSH nr.1648/1 prot, datë 14.04.2025.

- Nga ana e organit procedues janë kryer të gjitha veprimet për zbardhjen e plotë të ngjarjes, por aktualisht Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ndodhet në pamundësi ligjore procedurale, pasi është në pritje të përgjigjes së letërporosisë dërguar autoriteteve belge. Nuk ka pasur raste të tjera si ky apo të ngjashme të ndjekura nga Prokuroria, ndaj në këto kushte **nuk** ka një protokoll të caktuar.
- Instituti i Mjekësisë Ligjore me shkresën **nr.1178/1 prot., datë 10.02.2025** sqaron se, në Institutin e Mjekësisë Ligjore nuk kryhet ekspertim përcaktimi ADN-je, pasi nuk disponohet aparat për përcaktimin e analizës së ADN-së. Ekspertimi i ADN-së kryhet vetëm në Laboratorin e Policisë Shkencore Tiranë, ekspertët e të cilit janë të trajnuar për të kryer këtë lloj ekspertimi.
- Me shkresën **nr.523/1 prot., datë 04.02.2025**, Instituti i Policisë Shkencore sqarohet se, nga ana e tyre është kryer akti i ekspertimit biologjik ADN-je nr.9272, datë 04.10.2023 i cili është administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Vendimi për kryerjen e këtij ekspertimi është regjistruar në IPSH në datën 21.07.2023 dhe prova materiale është administruar me procesverbal mbi marrjen e provës materiale të datës 18.09.2023.
- Prova materiale është kthyer bashkë me aktin e ekspertimit.
- Në sektorin e biologjisë pranë IPSH-së, kryhen analiza me qëllim përfitimin e të dhënave gjenetike të caktuara të ADN-së (lokuse) të cilat shërbejnë për identifikimin e personit. Në rastin konkret janë përgatitur mostra nga prova materiale dhe janë ekzaminuar sipas protokolleve teknike që disponon ky sektor. Nuk kanë patur raste të tjera për ekzaminim të provës materiale të ruajtura në formalinë.
- Me shkresën **nr.K2/M3-9 prot., datë 25.03.2025**, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë i ka kërkuar informacion më të hollësishëm Institutit të Policisë Shkencore, duke qenë se pas ndërhyrjes së Ministrisë së Drejtësisë, shteti austriak nuk e merr përsipër kryerjen e ekzaminimit mjeko-ligjor të zemrës, ndërsa nga shteti belg nuk është kthyer përgjigje as pas shkresave të përsëritura.
- Me shkresën **nr.1648/1 prot., datë 14.04.2025**, Instituti i Policisë Shkencore i qëndron mendimit të dhënë më parë se, është kryer akti i ekspertimit biologjik ADN-je nr.9272, datë 04.10.2023 i cili është administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
- Ministria e Drejtësisë me shkresën **nr.2358/9 prot., datë 04.02.2025** sqaron se, në vijim të komunikimit mbi procedimin penal nr.6607 të Prokurorisë pranë Gjykatës

së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për veprën penale “shitblerja e paligjshme e organeve”, ka ushtruar kompetencat ligjore të parashikuara në aktet ndërkombëtare dhe legjislacionin procedural vendas. Ky institucion i ka dhënë rrugë letërporosive me objekt “kryerjen e ekspertizës së organit”, duke i transmetuar drejt Austrisë dhe Belgjikës. Me kërkesë të prokurorisë, është kërkuar në mënyrë të përsëritur nga autoritetet austriake dhe belge përshpejtimi si dhe informacion nëse do të marrin përsipër kryerjen e ekspertizës, objekt i këtyre letërporosive.

- Ministria e Drejtësisë, në cilësinë e autoritetit qendror në bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtare në fushën penale, shqyrton letërporosinë, çmon zbatueshmërinë e gjithë legjislacionit procedural penal të huaj dhe të brendshëm dhe vendos dhënien rrugë drejt apo nga autoritetet e huaja.
- Në zbatim të legjislacionit të lartpërmendur, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë **thekson se ekzekutimi i letërporosive bëhet konform legjislacionit procedural penal të vendit ku është kërkuar ekzekutimi.** Ndërkohë, ekzekutimi i letërporosive/letërkërkesave nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë kryhet sipas përcaktimeve të ligjit nr.10 193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”.

III. Analiza e rezultateve të hetimit administrativ referuar legjislacionit përkatës.

Avokati i Popullit konstaton se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka filluar hetimet **5 vjet më parë** për këtë çështje dhe ende nuk i ka finalizuar ato me një vendimarrje konkrete. Gjithashtu, kanë kaluar **2 (dy) vjet nga marrja fizike e zembrës**, rregjistruar me nr.B20-02222, të marrë në datën 12 korrik 2023 nga shteti spanjoll dhe të sjellë në Shqipëri si provë materiale dhe ende nuk është kryer ekzaminimi mjeko-ligjor i saj.

Pavarësisht kërkesave për ndihmë juridike të vazhdueshme të Ministrisë së Drejtësisë me autoritetet belge, nuk ka përgjigje për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor të zembrës së të ndjerit S.S.

Avokati i Popullit konstaton se nga autoritetet shqiptare nuk është parë si mundësi kryerja e ekspertizës në laboratorë private jashtë vendit. **Zbulimi i të vërtetës në rastet e vdekjeve të dyshimta dhe zbardhja e çështjes është detyrimi që prokuroria duhet të përmbushë, duke qenë se ekziston mundësia e kryerjes së ekspertizës mjeko-ligjore edhe në laboratorë private, ndaj ky fakt duhet të merrej parasysh nga prokuroria shqiptare.**

Referuar rastit konkret, kryerjes së ekspertizës mjeko-ligjore edhe në laboratorë privatë, rezulton të jetë prova e vetme e cila do të përcaktojë shkakun kryesor të vdekjes dhe do t'i jap përgjigje përfundimtare edhe ankesës së motrës së të ndjerit.

Sjellim në vëmendjen Tuaj se familjarët (trashëgimtarët) e viktimës gëzojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor të parashikuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe nga Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, të drejtën për informim, njoftim, si dhe të drejtat e parashikuara në nenin 58 të Kodit të Procedurës Penale⁴.

Konkretisht :

- **Në nenin 15 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, përcaktohet shprehimisht: *“Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. 2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.”*
- **Neni 21 i Kushtetutës** së RSH-së parashikon se, jeta e personit mbrohet me ligj.
- **Në nenin 55 të Kushtetutës** së Republikës së Shqipërisë përcaktohet: *“1. Shtetasit gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti. 2. Kushdo ka të drejtë për sigurim shëndetësor sipas procedurës së caktuar me ligj.”*
- **Deklarata Universale e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut**, citon se: *“Çdokush ka të drejtën për një standard jetese të përshtatshëm për shëndetin*

⁴ 1. Viktima e veprës penale ka të drejtë:

- a) të kërkojë ndjekjen penale të fajtorit;
 - b) të përfitojë kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse për ndihmën ndaj viktimave të veprës penale;
 - c) të komunikojë në gjuhën e saj dhe të ndihmohet nga një përkthyes, interpretues i gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit për personat me aftësi të kufizuara në të folur dhe në të dëgjuar;
 - ç) të zgjedhë mbrojtësin dhe, kur është rasti, të përfitojë ndihmë juridike falas, sipas legjislacionit në fuqi;
 - d) të kërkojë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihet me aktet e provat, pa cenuar parimin e sekretit hetimor;
 - dh) të kërkojë marrjen e provave, si dhe të parashtojë kërkesa të tjera përpara organit procedues;
 - e) të informohet për arrestimin e të akuzuarit dhe lirinë e tij, në kushtet e caktuara në këtë Kod;
 - ë) të njoftohet për mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes, fillimin dhe përfundimin e gjykimit;
 - f) të bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedimin dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake për të pushuar akuzën ose çështjen;
 - g) të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal;
 - gj) të përjashtohet, në kushte të caktuara me ligj, nga pagimi i çdo shpenzimi për marrjen e akteve dhe tarife gjyqësore për paraqitjen e kërkesë-padisë që lidhen me statusin e viktimës së veprës penale;
 - h) të thirret në seancën paraprake dhe në seancën e parë gjyqësore;
 - i) të dëgjohet nga gjykata, edhe kur asnjëra nga palët nuk ka kërkuar thirrjen e saj si dëshmitar;
 - j) të ushtrojë të drejta të tjera të parashikuara nga ky Kod.
2. Organi procedues njofton menjëherë viktimën për të drejtat e përmendura në paragrafin 1, të këtij neni, dhe mban procesverbal për njoftimin e tyre.
3. Viktima që nuk ka zotësi për të vepruar i ushtron të drejtat e saj nëpërmjet përfaqësuesit ligjor ose kujdestarit të tij, përveçse kur kjo nuk është në interesin e viktimës. Kur vëren papajtueshmëri mes interesave të viktimës dhe atyre të përfaqësuesit ligjor ose kujdestarit, gjykata cakton një kujdestar të posaçëm, në përputhje me dispozitat e Kodit të Familjes.
4. Trashëgimtarët e viktimës kanë të drejtat e parashikuara në shkronjat “a”, “e”, “ë”, “f”, “g” dhe “j”, të paragrafit 1, të këtij neni. Nëse trashëgimtari i viktimës është i mitur, ai përfaqësohet nga kujdestari ligjor.

dhe mirëqenien⁵.” Një standard i tillë jetese përfshin ushqimin e mjaftueshëm të duhur dhe të mirë, veshjen, strehimin, kujdesin mjekësor dhe shërbimet e nevojshme sociale. E drejta e jetës është e ndërthurur në mënyrë të ngushtë me të drejtën për shëndetin.

- **Neni 2 i Konventës Evropiane i të Drejtave të Njeriut** përcakton parimin themelor të drejtën për jetën:

“E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t’i merret jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjyqësor me vdekje, pas dënimit për një krim për të cilin ky dënim është parashikuar me ligj.

Marrja e jetës nuk konsiderohet të jetë shkaktuar në kundërshtim me këtë nen në rastet kur ajo vjen si pasojë e përdorimit të forcës, që është jo më shumë se absolutisht e nevojshme:

- a. në mbrojtje të çdo personi nga dhuna e paligjshme;*
- b. për të kryer një arrestim të ligjshëm ose për të parandaluar arratisjen e një personi të cilit i është hequr liria ligjërisht;*
- c. për të kundërshtuar, në përputhje me ligjin, një trazirë ose kryengritje.”*

E drejta për jetën renditet e para, sepse është e drejta e njeriut më themelore nga të gjitha: nëse ndokush do të privohet në mënyrë arbitrare nga e drejta e tij për jetën, të gjitha të drejtat e tjera bëhen joreale. E drejta e jetës është e drejta më e rëndësishme, pasi gëzimi i saj përbën burimin e të gjitha të drejtave të tjera të derivuara prej saj.

Neni 2 i KEDNJ-së renditet si një nga dispozitat më themelore në Konventë – në fakt një dispozitë e tillë që në kohë lufte nuk pranon derogime në bazë të nenit 15. Së bashku me nenin 3 të Konventës [ndalimi i torturës], **ajo mishëron një nga vlerat bazë të shoqërive demokratike që përbëjnë Këshillin e Evropës⁶.**

- **GJEDNJ-ja** ka konstatuar se neni 2 vendos një “detyrim pozitiv” ndaj shteteve për të hetuar mbi vdekjet që mund të jenë hasur në shkelje të këtij neni. Ky kusht procedural u deklarua fillimisht në **cështjen McCann**, në lidhje me vrasjet e kryera nga agjentë të Shtetit⁷.
- **Në nenin 13 të KEDNJ** përcaktohet e drejta për zgjidhje efektive dhe se çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e **një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar**, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

Nga hetimi administrativ i kryer nga institucioni i Avokatit të Popullit, konstatohet se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka regjistruar procedimin dhe ka vijuar me hetimet, **por prej një kohe të gjatë këto hetime**

⁵<https://kmd.al/wp-content/uploads/2018/05/1524735491->

DEKLARATA-UNIVERSALE-E-TE-DREJTAVE-TE-NJERIUT.pdf

⁶ <https://rm.coe.int/handbook-8/16806fc13d>

⁷ Vendimi i Dhomës së Madhe tek McCann, para. 149.

kanë ndaluar⁸. Kërkesat e përsëritura nuk konsiderohen veprime hetimore. Njëkohësisht, ato nuk e kanë përmbushur qëllimin e hetimit efektiv, si dhe përfundimin e tij brenda një afati të arsyeshëm.

Familjarët e viktimës, S.S kërkojnë respektimin e nenit 6 të KEDNJ-së e drejta për një proces të rregullt⁹. Respektimi i afatit të arsyeshëm për kryerjen e hetimeve penale është garanci për qytetarët.

E drejta për një **proces të rregullt ligjor** parashikohet në nenin 131/f të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Garancitë e parashikuara në nenin 6 zbatohen jo vetëm në proceset gjyqësore, por edhe në fazat që paraprijnë dhe pasojnë ato. Duke qenë një e drejtë kushtetuese, e drejta për një proces të rregullt ligjor e vendos organin procedues para një sërë detyrimesh, si në

⁸ Në nenet 323 dhe 324 të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet si vijon:

Neni 323

1. Brenda përfundimit të afatit ligjor të hetimeve, prokurori vendos sipas paragrafit 6, të nenit 327, të këtij Kodi.
2. **Afati i përfundimit të hetimeve është tre muaj nga data në të cilën emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, dhe gjashtë muaj për veprat penale të parashikuara nga shkronjat “a” dhe “b”, të nenit 75/a, të këtij Kodi.**

Neni 324

1. Prokurori mund ta zgjasë afatin e hetimeve për një kohë deri në tre muaj. Në rastin e Prokurorisë së Posaçme ky afat është deri në gjashtë muaj.
2. Zgjatje të mëtejshme, secila për një kohë jo më shumë se tre muaj, mund të bëhen nga prokurori në rastet e hetimeve komplekse ose të pamundësisë objektive për t'i përfunduar ato brenda afatit të zgjatur. Kohëzgjatja e hetimeve paraprake nuk mund të kalojë dy vjet. Tej afatit 2-vjeçar, për raste të akuzave për krim të organizuar dhe për krime që gjykohen me trup gjykues, afati i hetimit mund të zgjatet vetëm me miratim të Prokurorit të Përgjithshëm ose Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme deri në 1 vit, për çdo zgjatje jo më shumë se tre muaj, pa cenuar afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit.
3. Vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve u njoftohet të pandehurit dhe të viktimës.
4. Provat e marra pas mbarimit të afatit nuk mund të përdoren.

⁹ 1. **Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.** Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

- a. të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;
- b. t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;
- c. të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;
- d. të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;
- e. të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.

respektimin e të drejtave procedurale dhe zhvillimin e hetimit e gjykimit brenda një “*afati të arsyeshëm*”, pa lejuar zvarritje të papërligjura dhe arbitrare prej tij. Shpejtimi i procedurave të hetimit dhe gjykimit është i lidhur drejtpërsëdrejti me të drejtat dhe liritë themelore nga njëra anë, si dhe detyrimin për realizimin e një hetimi e gjykimi objektiv, të plotë, të saktë e të shpejtë nga ana tjetër.

Avokati i Popullit vlerëson se funksionimi i sistemit të drejtësisë dhe organit të akuzës prej disa viteve po përballlet me vështirësi dhe sfida të mëdha por kjo nuk mund të shërbejë si element për të vonuar realizimin e një hetimi apo gjykimi objektiv, të plotë, të saktë, në përputhje me të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

Sjellim në vëmendjen tuaj se kohët e fundit GJEDNJ-ja ka konstatuar në shumë raste të çështjeve me individë të ndryshëm kundër shtetit shqiptar se është shkelur paragrafi 1, i nenit 6 të Konventës, në lidhje me kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore në fjalë.

Konkretisht, në çështjet **Papakostandini kundër Shqipërisë** (kërkesa nr. 7568/08)¹⁰ dhe **Fortuzi kundër Shqipërisë** (kërkesa nr.29237/18)¹¹ shprehet që është shkelur paragrafi 1, i nenit 6 të Konventës, në lidhje me kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore në fjalë. Duke pasur parasysh praktikën e saj gjyqësore për temën, Gjykata vlerëson se në këtë çështje kohëzgjatja e proceseve ishte e tejkaluar dhe nuk plotësonte kërkesën e “kohës së arsyeshme”.

Nga hetimi administrativ i rastit konkret është konstatuar se janë kryer hetime dhe janë marra masa për bashkëpunim me autoritetet e huaja nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, **por prej një kohe të gjatë, nuk ka përparim në ecurinë e procedimit penal.**

Çdo vonesë e mëtejshme në kryerjen e veprimeve procedurale është në dëm të procesit të rregullt ligjor dhe cenon rëndë besimin e publikut te organi i prokurorisë.

Duke marrë parasysh rëndësinë e veprimeve hetimore për zbardhjen e plotë të çështjes penale dhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor, rekomandohet që organi i prokurorisë të ndërmarrë menjëherë masat e nevojshme për të përshpejtuar kryerjen e analizës së ADN-së të zemrës së viktimës, si një provë qenësore për hetimin.

Sipas **nenit 277 dhe vijues të Kodit të Procedurës Penale** të Republikës së Shqipërisë, organet proceduese janë të detyruara të kryejnë në kohë çdo veprim hetimor që ka rëndësi për çështjen, duke shmangur çdo zvarritje të pajustificuar.

Moskryerja në kohë e analizës së ADN-së:

¹⁰ <https://www.avokaturashitetit.gov.al/vendimet-e-strasburgut/vendimet-e-gjykates-evropiane-per-te-drejtave-te-njeriut-strasburg>

¹¹ <https://www.avokaturashitetit.gov.al/vendimet-e-strasburgut/vendimet-e-gjykates-evropiane-per-te-drejtave-te-njeriut-strasburg>

- **Përbën një mosveprim që cenon tërësinë e hetimit penal;**
- **Mund të rezultojë në humbjen ose degradimin e provave biologjike;**
- **Dëmton interesin e palëve për drejtësi të shpejtë dhe efektive;**
- **Rrezikon besimin publik në organet e drejtësisë.**

Po ashtu, çmujmë se nga pikëpamja administrative buxhetore, drejtuesit e prokurorisë duhet të mbështesin prokurorët që këta të fundit të marrin masat e nevojshme procedurale dhe efektive për të evituar çdo zvarritje në ndjekjen e kësaj çështjeje, **kryerjen e aktit të ekspertimit të ADN-së së zemrës qoftë edhe me pagesë në laboratorë të specializuar privatë dhe me ekspertë të licencuar për kryerjen e këtij ekspertimi**, si dhe mbylljen sa më parë të veprimeve hetimore, pasi po cenohet e drejta për një proces të rregullt ligjor.

Kryerja sa më parë e analizës së ADN-së është thelbësore për garantimin e një hetimi të plotë, të paanshëm dhe në përputhje me parimet themelore të shtetit të së drejtës. Prandaj, prokuroria duhet të angazhojë menjëherë laboratorë të licencuar për kryerjen e ekzaminimit të ADN-së, duke ndjekur standardet procedurale dhe duke garantuar transparencë në çdo hap të procesit.

Familjarët nuk mund të rrinë në pritje të pafundme të përgjigjes për kryerjen e ADN-së. Mendojmë se duhet të ndërmerren hapa të shpejta për kërkimin e bashkëpunimit në disa vende të tjera evropiane, si dhe kryerjen sa më parë të ekspertimit të zemrës.

Në respektim të **nenin 42, pika 2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë** në të cilin përcaktohet: *“Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”*.

Legjislacioni procedural penal ka për detyrë të sigurojë një procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, të mbrojë liritë personale dhe të drejtat e interesat e ligjshme të shtetasve, të ndihmojë për forcimin e rendit juridik dhe zbatimin e kushtetutës e të ligjeve të shtetit.

Në çështjen **Prizreni kundër Shqipërisë**¹² pavarësisht se ky rast bën fjalë për rastin kur personat gjenden në burg dhe nuk është i njëjtë me rastin objekt i rekomandimit, GJEDNJ ka interpretuar detyrimin procedural të nenit 2 të Konventës, duke iu kërkuar shteteve të ngrenë një sistem efikas dhe të pavarur gjyqësor, në mënyrë që shkaku i vdekjes së pacientëve nën kujdesin mjekësor, qoftë në sektorin publik apo në atë privat, mund të përcaktohet dhe të vihen përpara llogaridhënies personat përgjegjës¹³. Po ashtu, GJEDNJ ka vënë re mungesa të veçanta në veprimet hetimore të ndërmarra nga autoritetet vendase.

¹² <https://www.scribd.com/document/693309376/Ceshtja-Prizreni-Kunder-Shqiperise>

¹³ shih Lopes de Sousa Fernandes kundër Portugalisë [DHM], nr. 56080/13, § 214, 19 dhjetor 2017, dhe Šilih kundër Sllovenisë [DHM], nr. 71463/01, § 192, 9 prill 2009

Këto autoritete nuk kanë kryer një hetim të përshtatshëm dhe efikas në rrethanat që kanë të bëjnë me vdekjen e vëllait të aplikantit.

Në vijim, gjykata deklaron, se kurdo që një i ndaluar vdes në rrethana të dyshimta, neni 2 u kërkon autoriteteve të kryejnë një hetim të pavarur dhe të paanshëm zyrtar, i cili përmbush standarde minimale të caktuara për efikasitetin¹⁴.

Ndërkohë që hetimi plotëson kushtet e mësipërme, theksi mbetet te zbulimi i të vërtetës në rastet e vdekjeve të dyshimta.

Një hetim duhet të jetë efikas në kuptimin që ai mund të çojë në përcaktimin e fakteve dhe, aty ku është me vend, të kryhet identifikimi dhe dënimi i personave përgjegjës. Edhe pse nuk është detyrim i rezultatit por i mjeteve, çdo deficiençë në hetime, të cilat dëmtojnë mundësinë për të përcaktuar rrethanat e çështjes ose personin përgjegjës, rrezikon të ketë parregullsi me standardin e kërkuar të efikasitetit¹⁵. Autoritetet duhet të veprojnë me pushtetin e tyre sapo çështja kalon në vëmendjen e tyre. Ato nuk mund ta lënë atë në iniciativën e të afërmit as për të paraqitur një ankesë formale ose për të kërkuar linja të posaçme hetimesh ose procedurash hetimesh¹⁶. Në të gjitha rastet, i afërmi i viktimës duhet të përfshihet në procedurë në masën e nevojshme për të mbrojtur interesat e tij/saj legjitimë¹⁷.

Një përgjigje e menjëhershme nga autoritetet në hetimin e vdekjeve të dyshimta mund të konsiderohet në përgjithësi si thelbësore në ruajtjen e besimit të publikut në mbështetje të shtetit të së drejtës dhe në parandalimit të çdo forme të marrëveshjeve të fshehta ose tolerancës ndaj akteve të paligjshme¹⁸.

Gjykata, në shumë raste, ka theksuar se përfshirja e të afërmit shërben për të garantuar llogaridhënien publike të autoriteteve dhe kontrollin publik të veprimeve të tyre gjatë hetimit. E drejta e familjes së të ndjerit, vdekja e të cilit është nën hetim, për të marrë pjesë në procedime, kërkon që procedura e miratuar të garantojë mbrojtjen e nevojshme të interesit të tyre, i cili mund të jetë në konflikt të drejtpërdrejtë me interesin e policisë ose forcave të sigurisë të përfshirë në ngjarje¹⁹. Pamundësia për shkak të mosparashikimeve të mjaftueshme ligjore në çështjen në fjalë, në mënyrë që kërkuesi të kundërshtojë në mënyrë efikase vendimin e prokurorit për mosfillimin e procedimeve penale, nuk është në linjë me detyrimin e shtetit për të kryer një hetim efektiv.

¹⁴ shih Trubnikov kundër Rusisë, nr. 49790/99, §§ 87-88, 5 korrik 2005

¹⁵ shih AlSkeini dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar [DHM], nr. 55721/07, §§ 166, GJEDNJ 2011

¹⁶ shih Nachova dhe të Tjerët kundër Bullgarisë [DHM], nr. 43577/98 dhe 43579/98, § 111, GJEDNJ 2005-VII

¹⁷ shih Mustafayev kundër Azerbajxhanit, nr. 47095/09, § 72, 4 maj 2017

¹⁸ shih Merkulova kundër Ukrainës, nr. 21454/04, § 50, 3 mars 2011, dhe Armani da Silva kundër Mbretërisë së Bashkuar [DHM], nr. 5878/08, § 237, 30 mars 2016

¹⁹ shih Anusca kundër Moldavisë, inr. 24034/07, § 44, 18 maj 2010

Sa më sipër, ndërkohë që përmbajtja e vendimeve nuk është në kompetencë të Avokatit të Popullit, administrimi i përgjithshëm i çështjeve hyn në kompetencën lëndore të Avokatit të Popullit në përputhje me nenin 21 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, si dhe Parimet e Komisionit të Venecias për institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut të vitit 2019²⁰.

Sipas këtyre parimeve Avokatit të Popullit i është përcaktuar një mandat i gjerë, i bazuar në standardet ndërkombëtare si institucioni më i lartë kombëtar për promovimin, parandalimin e shkeljeve dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Edhe vetë Komisioni i Venecias, duke njohur dhe pranuar parimet themelore të institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut të tilla si pavarësia, objektiviteti, transparencja, drejtësia, paanshmëria si dhe duke e konsideruar se këto institucione janë një element i rëndësishëm në një shtet të bazuar në demokraci, sundim të ligjit, respektim të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe qeverisje të mirë ka miratuar parimet mbi mbrojtjen dhe promovimin e institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut.

Avokati i Popullit përgëzon faktin që hetimet kanë nisur dhe që po bëhen përpjekje për zbardhjen e të vërtetës, por vëren se disa pamundësi teknologjike e kanë lënë procesin në një gjendje pezullimi faktik për një kohë të gjatë. Sistemi i drejtësisë duhet të sigurojë që drejtësia të jepet.

E para dhe më e rëndësishmja që çmon Avokati i Popullit, është garancia me kohëzgjatjen e hetimeve. Gjithashtu, vendos theksin tek rëndësia që ka transparencja dhe e drejta e palëve për informim si element thelbësor i të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Rritja e besimit që qytetarët duhet të kenë tek sistemi i drejtësisë mund të realizohet vetëm me ndryshimin e qasjes së organit të prokurorisë sa i takon informimit dhe njoftimit të qytetarëve.

Në vijim të kryerjes së misionit kushtetues e ligjor *në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend* dhe me qëllim rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur të ankueses, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”, në ligjin nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, respektivisht në nenin 21/b, ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”, dhe në nenin 21/c, ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen,*

REKOMANDOJMË:

²⁰ [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2019\)005-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2019)005-e)

1. Marrjen e masave nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Ministria e Drejtësisë, **për kryerjen sa më parë të ADN-së së zemrës së shtetasit S.S**, në bashkëpunim me shtete të tjera apo me pagesë në laboratorë të specializuar (privatë) për kryerjen e këtij ekspertimi, duke siguruar dokumentimin dhe transparencën e plotë të këtij veprimi, si dhe vënien e rezultatit në dispozicion të palëve të interesuara.
2. Marrjen e masave nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për të informuar dhe njoftuar familjarët e viktimës S.S, në kuadër të procesit të rregullt ligjor.
3. Marrjen e masave të menjëhershme nga Prokuroria e Përgjithshme për parashikimin e fondeve buxhetore përkatëse për kryerjen e ekzaminimeve për raste të ngjashme që janë në procedim ose mund të paraqiten në të ardhmen.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Erinda BALLANCA

D.V